



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MINT) Nr. 05/2024
PËR
PËRMBAJTJEN E STUDIMIT TË
FIZIBILITETIT PËR PARQET INDUSTRIALE DHE TEKNOLOGJIKE

Udhëzim Administrativ (MINT) Nr.05/2024 Për Përmbajtjen e Studimit të Fizibilitetit për Parqet Industriale dhe Teknologjike, është aprovuar me Vendimin Nr. 3846/01 Datë. 07.08.2024



Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë,

Në mbështetje të nenit 8, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 08/L-208 për Parqet Industriale dhe Teknologjike, Shtojcës 12 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 9, paragrafi 2 të Rregullores Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës,

Nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV(MINT) Nr. 05/2024
PËR
PËRMBAJTJEN E STUDIMIT TË
FIZIBILITETIT PËR PARQET INDUSTRIALE DHE TEKNOLOGJIKE**

**Neni 1
Qëllimi**

Me këtë udhëzim administrativ përcaktohet arsyeshmëria ekonomike, fiskale, mjedisore, ligjore dhe administrative e studimit të fizibilitetit për themelimin e Parkut Industrial dhe Teknologjik.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Ky udhëzim administrativ zbatohet ndaj autoriteteve publike, investitorëve, shoqërive tregtare vendore dhe ndërkombëtare të regjistruara në Republikën e Kosovës, ose asociacioneve të biznesit vendor dhe ndërkombëtar të regjistruara në Republikën e Kosovës.

**Neni 3
Përkufizimet**

1.Shprehjet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë kuptimet e përcaktuara me këtë nen:

1.1. Ministria – ministria përgjegjëse për industrinë, ndërmarrësinë dhe tregtinë;



1.2. Park industrial dhe teknologjik - pronë e paluajtshme e ndarë dhe e rrethuar ku zhvillohen veprimtari ekonomike sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj. Parku industrial dhe teknologjik përfshin:

1.2.1. hapësirën e shërbimeve të domosdoshme për shfrytëzuesit;

1.2.2. infrastrukturën e përbashkët duke përfshirë rrugët, rrjetin e energjisë elektrike, rrjetin e telekomunikimit, ujësjellësin dhe kanalizimin dhe lehtësira tjera sipas legjislacionit në fuqi;

1.3 Studimi i fizibilitetit – është vlerësimi i avantazhit ekonomik, i cili bazohet në kryerjen, llogaritjen dhe analizimin e një numëri të parametrave;

1.4 Plani i investimit - investimi i një shume të caktuar parash në intervale të rregullta në ndërtim të infrastrukturës fizike të Parkut Industrial dhe Teknologjik;

1.5. Konkluzionet përfundimtare - rezultatet përfundimtare të nxjerrura në studim të fizibilitetit për ndërtimin e parqeve industriale dhe teknologjike.

Neni 4

Llojet

1. Parku industrial dhe teknologjik mund të jetë:

1.1. Park i përgjithshëm - park me ose pa ndërtesa industriale të ndërtuara paraprakisht, i destinuar përgjithësisht për veprimtari ekonomike;

1.2. Park i specializuar - park me ose pa ndërtesa industriale të ndërtuara paraprakisht, i destinuar për industritë specifike dhe veprimtarive të ndërlidhura;

1.3. Park për inovacion dhe teknologji - park i destinuar për veprimtari që lidhen me inovacionin, institucionet e arsimit të lartë dhe arsimit e aftësimin profesional, teknologjinë e avancuar dhe zhvillimin e prototipave në funksion të veprimtarive ekonomike.

2. Në përputhje me llojin nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të përcaktohen sektorët dhe veprimtaritë e parkut.



Neni 5

Hartimi i studimit të fizibilitetit

1. Hartimi i studimit të fizibilitetit bëhet nga institucioni publik përkatës ose nga operatori ekonomik i fushës përkatëse, i përzgjedhur sipas ligjit përkatës për prokurimin publik.
2. Kriteret për përzgjedhjen e operatorit ekonomik, do të përcaktohen në bazë të thirrjes publike të shpallur nga propozuesi i Parkut Industrial dhe Teknologjik;

Neni 6

Arsyeshmeritë e studimit të fizibilitetit të Parkut Industrial dhe Teknologjik

1. Studimi i fizibilitetit për Parqet Industriale dhe Teknologjike sipas nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-208, duhet të përmbajë:
 - 1.1. arsyeshmërinë ekonomike,
 - 1.2. arsyeshmërinë fiskale,
 - 1.3. arsyeshmërinë mjedisore,
 - 1.4. arsyeshmërinë ligjore dhe
 - 1.5. arsyeshmërinë administrative

Neni 7

Arsyeshmëria ekonomike për ndërtimin e Parkut Industrial dhe Teknologjik

1. Studimi i fizibilitetit në arsyeshmërinë ekonomike për Parkun Industrial dhe Teknologjik përmban:
 - 1.1. ndikimin financiar, ekonomik dhe social;
 - 1.2. hulumtimin dhe ndikimin e rritjes së tregut;
 - 1.3. fuqinë punëtore, arsimimin, moshën, gjininë, kualifikimet, punësimin;
 - 1.4. numrin e bizneseve;
 - 1.5. llojin e bizneseve sipas veprimtarisë ekonomike;



- 1.6. përfitimet në punësim; pozitën gjeografike në raport me rajonin;
- 1.7.eksportin dhe importin;
- 1.8.mënyrat /format e financimit e ndërtimit;
- 1.9. planin financiar të realizimit të projektit/afatet kohore;
- 1.10. analizën e rrishtit;
- 1.11. kapacitetet, planin e marketingut dhe kostot.

Neni 8

Arsyeshmëria fiskale për ndërtimin e Parkut Industrial dhe Teknologjik

1. Studimi i fizibilitetit në arsyeshmërinë fiskale për Parkun Industrial dhe Teknologjik përmban:
 - 1.1 aplikimin e tatimeve dhe taksave;
 - 1.2 të ardhurat e pritshme dhe përfitimet;
 - 1.3 investimet e huaja direkte;
 - 1.4 stimujt fiskal (shkalla e taksës në fitim);
 - 1.5 stimujt në punësim;
 - 1.6 stimujt tjerë, nëse ka.

Neni 9

Arsyeshmëria mjedisore për ndërtimin e Parkut Industrial dhe Teknologjik

1. Studimi i fizibilitetit në arsyeshmërinë mjedisore për Parkun Industrial dhe Teknologjik, përmban:
 - 1.1.ndikimin e përgjithshëm në mjedis;
 - 1.2.fazën e ndikimit në mjedis gjatë procesit të ndërtimit;



- 1.3.ndikimi në mjedise gjatë fazës së operimit të Parkut industrial dhe teknologjik;
- 1.4.paraqitja e koordinatave të pozitive të shpimeve, sipas standardeve të aplikueshme;
- 1.5.hartimin e elaboratit gjeologjike – gjeomekanike dhe hidrogjeologjike;
- 1.6.trajtimin e mbeturinave;
- 1.7.planin ideor për trajtimin e ujërave të zeza dhe industriale, duke respektuar normat e ndikimit në mjedis;
- 1.8.planin për furnizim me energji elektrike;
- 1.9. planin për furnizim me ujë të pijshëm;
- 1.10.planin për furnizim me ujë industrial.

Neni 10

Arsyeshmëria ligjore për ndërtimin e Parkut Industrial dhe Teknologjik

1. Studimi i fizibilitetit në arsyeshmërinë ligjore për Parkun Industrial dhe Teknologjik, përmban:
 - 1.1. legjisllacionin përkatës për parqe industriale dhe teknologjike dhe
 - 1.2. pajtueshmërinë me ligjet përkatëse, për mjedisin, për ujërat, për mbrojtje nga zhurma, për mbrojtje të natyrës si dhe ligjet tjera të aplikueshme.

Neni 11

Arsyeshmëria administrative për ndërtimin e Parkut Industrial dhe Teknologjik

1. Studimi i fizibilitetit në arsyeshmërinë administrative për Parkun Industrial dhe Teknologjik, përmban:
 - 1.1. kufijtë - matjet gjeodezike (kopja e planit);
 - 1.2. fletën poseduese të pronës;
 - 1.3.kategorizimin e tokës;



1.4.planin hapësinor të Kosovës;

1.5.planin zhvillimor komunal;

1.6.hartën zonale;

1.7.pëlqimin mjedisor

1.8.disponueshmëria e shërbimeve komunale;

1.9.lejet/kohëzgjatje e procedurave të palëve të përfshira, dokumentet e kërkuara dhe afatet.

Neni 12 Përfundimet

Studimi i fizibilitetit duhet të përmbajë konkluzionet të cilat përfshijnë rezultatet përfundimtare të nxjerrura në studim të fizibilitetit për ndërtimin e parqeve industriale dhe teknologjike.

Neni 13 Dispozita shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ (MTI) Nr. 02/2014 për Përmbajtjen e Studimit të Fizibilitetit.

Neni 14 Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

06.08.2024

Rozeta Hajdari

Ministre